VENDIM
Nr.444, datë 3.9.1993

PËR KRIJIMIN E KOMITETIT KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA

Me propozimin e Ministris se Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pranë Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit krijohet Komiteti Kombëtar i Digave të Medha, si organ këshillues i Këshillit të Ministrave, me këto detyra:

a) Të ndjekë zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave në fushën e zhvillimit të teknikës e të teknologjisë bashkëkohore në studimet e projektimet, në ndërtimin, shfrytëzimin e në mbikqyrjen e kontrollit të vazhdueshëm e të organizuar shtetëror nga institucionet studimore e projektuese, ndërmarrjet e ndërtimit e të shfrytëzimit, si dhe të ndihmojë që të rritet përgjegjësia, disiplina teknike e siguria në digat, të cilat janë vepra të rëndësishme e komplekse.

b) Të kontrollojë zbatimin e kushteve e të normave teknike, si dhe të rregullave e të udhëzimeve në projektim, zbatim, shfrytëzim e në mbikëqyrjen e kontrollin e detyrueshëm të digave.

c) Të shqyrtojë e miratojë paraprakisht projektetet e digave, përpara miratimit të tyre në organet përkatëse, sipas dispozitave në fuqi.

ç) Të shqyrtojë e miratojë dokumentacionin teknik për vënien në shfrytezim të pjesshëm a të plotë të digave.

d) Të pezullojë zbatimin e propjekteve, ndërtimin dhe shfrytëzimin e digave, kur vëren shkelje të kushteve teknike të projektimit, të teknologjisë së ndërtimit e të shfrytëzimit të digave.

dh) Të mbajë evidencë të plotë për digat e ndërtuara e në ndërtim e sipër dhe të ndjekë mbajtjen e evidencave e të dokumentacionit të plotë të projekteve, zbatimin e rregullave të mbikqyrjes e të kontrollit të tyre nga administrata e ndërmarrjeve gjatë ndërtimit e shfrytëzimit dhe të realizojë një relatim një herë në vit pranë Këshillit të Ministrave.

e) Të shqyrtojë avaritë dhe dëmtimet kryesore që ndodhin në digat e mëdha, duke aktivizuar edhe specialistë të ndryshëm që nuk janë në përbërje të këtij komiteti, dhe të propozojë masat që duhen marrë për mënjanimin e avarive.

2. Veprimtaria e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha, si rrëgull shtrihët ne te gjitha digat qe kanë lartësi mbi 15 m, nga pjesa e thellë e bazamentit deri në kurorën e digës, dhe në digat me lartësi mbi 10 m, kur plotësojnë një nga këto kushte:

- gjatësia e kurrorës së digës është mbi 500 m;
- vëllimi i rezervuarit që krijohet është mbi 1 milion m3;
- kur ka kushte të veçanta gjeologjike të bazamentit.

3. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha mban lidhje me Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha dhe ndjek detyrimet që ka vendi ynë nga pjesëmarrja në këtë komision.

4. Komiteti Kombëtar i digave të Mëdha përbëhet nga kryetari, nënkryetari, sekretari dhe 14 anëtarë, të cilët miratohen nga Kryesia e Këshillit të Ministrave.

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha merr vendime me shumicë votash dhe vepron sipas rregullores së brëndshme që miratohet nga kryetari.

Në strukturën organizative të aparatatit të Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit shtohet "Sekretari i Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha".

5. V.K.M. nr.77, datë 20.2.19986 "Për krijimin e Komitetit Shqiptar të Digave të Mëdha", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi